



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 514/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesues, Zyhdi Haziri dhe Afijete Sada Glllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Gentiana Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e SDU- Duda Balje, paraqitur kundër iniciativës qytetare Adriana Hodzic dhe koalicionit Vakati- Rasim Demiri, për shkak të parregullsive në qendrat e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur më 16.02.2021, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HUDHEN** të pa lejuara ankesat A.nr.514/2021 dhe A.nr.515/2021 të datës 15.02.2021, paraqitur nga SDU- Duda Balje, kandidatë për deputetë nga radhët e subjektit politik SDU- Duda Balje kundër iniciativës qytetare Adriana Hodzic në Mitrovicë Veriore dhe koalicionit Vakati- Rasim Demiri në Prizren, për shkak të parregullsive në qendrat e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021.

## **A r s y e t i m**

Paneli, ka pranuar ankesat A.nr.514/2021 dhe A.nr.515/2021 të datës 15.02.2021 të paraqitura nga SDU- Duda Balje, kandidatë për deputetë nga radhët e subjektit politik SDU- Duda Balje kundër iniciativës qytetare Adriana Hodzic në Mitrovicë Veriore dhe koalicionit Vakati- Rasim Demiri në Prizren në të cilat pretendohet se nga ana e iniciativës qytetare Adriana Hodzic në Mitrovicë Veriore dhe koalicionit Rasim Demiri në Prizren është bërë shkelje e procedurave ligjore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në atë mënyrë që me qëllim të manipulimit të vullnetit të komunitetit boshnjak është bërë keqpërdorimi i të drejtës së votës nga komuniteti joboshnjak në komunat Laposaviq, Novobërdë, Shterpc, Zubin Potok, Zveqan, Graçanicë, Ranilluk, Partesh, Kllokot dhe Mitrovicë Veriore pasi që këto vota nuk janë nga komuniteti boshnjak për faktin se në këto komuna nuk ka banorë boshnjakë me të drejtë vote sikurse rezultati i dalur nga zgjedhjet. Parashtruesi i ankesës ka pretenduar se kjo strategji është organizuar nga lista serbe me qëllim të vendosjes së disa figurave “kukullave” në vendet e rezervuara për

komunitete pakicë në parlamentin e Republikës së Kosovës duke ia mohuar kështu të drejtën kushtetuese përfaqësueseve legjitim të cilët i kanë fituar votat nga pjesëtarët e komunitetit boshnjak të cilët i përfaqësojnë. Andaj sipas ankuesit një manipulim i tillë i votave nuk guxon të lejohet të ndodhë sepse rrezikon rendin juridik të RKS-së si shtet multietnik me uzurpimin e të drejtës legjitime të vendeve të rezervuara për komunitetet që duhet të përfaqësohet nga komunitetet tjera dhe kjo mund të shndërrohet në precedent në zgjedhje tjera duke e rrezikuar edhe vet sigurinë, rendin juridik dhe sigurinë shtetërore të RKS-së. Në fund parashtruesi i ankesës i ka propozuar PZAP-së që të bëjë anulimin e votave në vendvotimet në komunat Leosaviq, Novobërdë, Shterpc, Zubin Potok, Zveqan, Graçanicë, Ranilluk, Partesh, Klllokot dhe Mitrovicë Veriore, në të cilat komuna numri i votuesve është më i lartë se i votuesit të regjistruar nga komuniteti boshnjak.

Paneli, në kuptim të nenit 7 par.1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it e informoi subjektin politik iniciativa qytetare Adriana Hodzic dhe koalicionin Vakati- Rasim Demiri në Prizren lidhur me ankesat e paraqitura ndaj tyre, nga subjekti politik SDU- Duda Balje, duke kërkuar që të përgjigjen ndaj ankesës deri më datë 16.02.2021 në ora 14:00.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

#### **Ankesat janë të pa lejuar**

Paneli, nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduara në ankesë përkitazi me parregullsitë në qendrat e votimit në komunat Leosaviq, Novobërdë, Shterpc, Zubin Potok, Zveqan, Graçanicë, Ranilluk, Partesh, Klllokot dhe Mitrovicë Veriore, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hedhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës së SDU- Duda Balje, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Ndërsa sa i përket pretendimeve tjera me ankese, pala ankuese është dashur apo duhet t'i drejtohet organeve tjera kompetente siç mund të jone: KQZ-ja, Policia, Prokuroria etj.

Paneli duke u mbështetur në Rregulloren Nr.02/2015, përkatësisht neni 6.4, me të cilën përcaktohet se: *“ankesa të cilat janë të pa lejuar dhe të pas afatshme PZAP-i, i hudhë si të pa lejueshme”* ankesa është e palejueshme për faktin se është paraqitur para afatit të paraparë ligjor.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe nenit 6 paragrafi 4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**A nr. 514/2021 më datën 16.02.2021**

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*

